

VENDIM
Nr. 345, datë 24.4.2013

**PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË TË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE, NË
FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, të shkronjës "ç" të nenit 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale, të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi për:

a) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 1, 18 (tetëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 460,1 (katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë presje një) m²;

b) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 2, 37 (tridhjetë e shtatë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 15 148 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e tetë) m²;

c) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 3, 131 (njëqind e tridhjetë e një) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 6 076,72 (gjashtë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e dy) m²;

ç) Drejtorinë e ALUIZNI-t Kavajë, 63 (gjashtëdhjetë e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 22 543 (njëzet e dy mijë e pesëqind e dyzet e tre) m²;

d) Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës, 99 (nëntëdhjetë e nëntë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 28 786 (njëzet e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë) m²;

dh) Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlora 1, 136 (njëqind e tridhjetë e gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 39 165,5 (tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë presje pesë) m²;

e) Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlora 2, 212 (dyqind e dymbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 81 643,5 (tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzet e tre presje pesë) m²;

ë) Drejtorinë e ALUIZNI-t Sarandë, 141 (njëqind e dyzet e një) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 60 926,6 (gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e gjashtë presje gjashtë) m²;

f) Drejtorinë e ALUIZNI-t Berat, 152 (njëqind e pesëdhjetë e dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 29 443, 94 (njëzet e nëntë mijë e katërqind e dyzet e tre presje nëntëdhjetë e katër) m²;

g) Drejtorinë e ALUIZNI-t Shkodër, 141 (njëqind e dyzet e një) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 23 129,17 (njëzet e tre mijë e njëqind e njëzet e nëntë presje shtatëmbëdhjetë) m²;

gj) Drejtorinë e ALUIZNI-t Fier 1, 143 (njëqind e dyzet e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 47 500,18 (dyzet e shtatë mijë e pesëqind presje tetëmbëdhjetë) m²;

h) Drejtorinë e ALUIZNI-t Fier 2, 210 (dyqind e dhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 81 053,4 (tetëdhjetë e një mijë e pesëdhjetë e tre presje katër) m²;

i) Drejtorinë e ALUIZNI-t Lushnjë, 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 25 822,9 (njëzet e pesë mijë e tetëqind e njëzet e dy presje

nëntë) m²;

j) Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan 1, 63 (gjashtëdhjetë e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 533,5 (tre mijë e pesëqind e tridhjetë e tre presje pesë) m²;

k) Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan 2, 106 (njëqind e gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 22 486,78 (njëzet e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e tetë) m²;

l) Drejtorinë e ALUIZNI-t Dibër, 16 (gjashtëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 615,7 (tre mijë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë presje shtatë) m²;

ll) Drejtorinë e ALUIZNI-t Gjirokastër, 34 (tridhjetë e katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 10 678,6 (dhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë presje gjashtë) m²;

m) Drejtorinë e ALUIZNI-t Korçë, 19 (nëntëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 393,66 (dy mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre presje gjashtëdhjetë e gjashtë) m²;

n) Drejtorinë e ALUIZNI-t Pogradec, 3 (tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 408,1 (katërqind e tetë presje një) m²;

nj) Drejtorinë e ALUIZNI-t Krujë, 128 (njëqind e njëzet e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 34 355 (tridhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) m²;

o) Drejtorinë e ALUIZNI-t Lezhë, 103 (njëqind e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 39 073,96 (tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e tre presje nëntëdhjetë e gjashtë) m²;

p) Drejtorinë e ALUIZNI-t Kukës, 54 (pesëdhjetë e katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 19 686,59 (nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë presje pesëdhjetë e nëntë) m²;

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha